



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 28 shkurt 2019, në mbledhjen e X-të (dhjetë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.20’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Fatlume Jaha, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fitim Haziri, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica dhe Floretë Zejnullahu.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, Donika Sfishta, drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit – DKRS, Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Mirsad Kamerolli, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues nga Rrjeti i OJQ-ve, Kujtim Hyseni dhe Rexhep Zeka.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues, e hapi mbledhje, përshëndeti të pranishmit, i njoftoi rreth pikave të paraqitura në këtë rend të ditës dhe shtoi, nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës urdhëroni, nëse jo e hedh në votim rendin e propozuar të ditës.

Njëzëri u votua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit të dërguar.

1. Ekstrakti i procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa më 28 janar 2019

Njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 28 janar 2019

2. Kërkesë e Kryetarit të Komunës për nismën e procedurës së bashkëpunimit komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit.

- *Propozim vendimi për miratimin e kërkesës – nismës së bashkëpunimit komunal ndërkombëtar – binjakëzimit me Qytetin Velbert në Gjermani.*
- *Propozim vendimi për autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për bashkëpunim komunal ndërkombëtar – binjakëzim me Qytetin Velbert në Gjermani.*

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, siç e keni parë edhe në material, Kryetari i Komunës e ka parë të arsyeshme ta fusim në rend të ditës për këtë mbledhje kërkesën – nismën për bashkëpunim ndërkombëtar duke dhënë edhe sqarimet dhe arsyet e nevojshme. Vlen të theksohet se paraprakisht janë zhvilluar takime dhe biseda mes përfaqësuesve të të dy Qyteteve në fjalë.

z.Avni Fetahu, theksoj, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së, e përkrahim këtë pikë dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

z.Fitim Haziri, theksoj, edhe ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e rekomandojmë këtë pikë për shqyrtim në Kuvendin e Komunës.

z.Rafet Llapashtica, theksoj, edhe ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së e rekomandojmë për kuvend këtë pikë dhe vlerësojmë se është e rëndësishme për arsyeje se kemi pasur disa vizita nga përfaqësuesit e asaj komune/qyteti. Edhe herën e kaluar kur ka qenë një kërkesë për autorizimin e përfaqësimit në nivel ndërkombëtar Kryetarit të Komunës i kemi japë mbështetje që Komuna e Podujevës të jetë prijëse e këtij procesi dhe unë mendoj që ky binjakëzim është shumë i rëndësishëm dhe besoj se është mirë të gjejmë forma edhe me komunat tjera. Besoj që edhe në seancë të Kuvendit do të mbështetet kjo kërkesë.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, të propozim vendimeve sipas materialit të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

3. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 në vitin 2019 dhe destinim në kategori të caktuara buxhetore.

z.Isuf Latifi, Drejtor DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, ky propozim ka të bëjë me bartjen e të hyrave të pa shpenzuara në vitin 2018 të cilat duhet të barten sipas ligjit në vitin 2019. Çdo e hyrë vetanake e realizuar gjatë vitit 2018 dhe e regjistruar në sistemin e SMFK-së, që nuk janë shfrytëzuar, automatikisht barten në vitin 2019, mirëpo sa për sqarim bartjet bëhen vetëm në projektet e pa realizuara të vitit 2018 pra është buxhet i vitit 2018 dhe duhen të barten obligimet të cilat kanë qenë të planifikuara në vitin 2018. Në bazë të specifikacionit për secili projekt është edhe kodi i po atij projekti i cili mund të gjendet edhe në ligjin e buxhetit 2018.

Kjo bartje sipas këtij propozim vendimi është përgatitur në bazë të analizave të secilës Drejtori për mjetet të cilat kanë qenë të pa shpenzuara, ku do të mbulohen obligimet e kontraktuara si obligime ligjore në mënyrë që mos të ndodh të përballemi me procedura përmbarimore ose gjyqësore.

z.Fitim Haziri, theksoj, nga DBF do të doja që kur po bëhen bartje të tilla të të hyrave, të jepen detaje pak më shumë rreth projekteve që kanë ngec, shembull, janë paraqitur disa projekte, si, asfaltimi i disa rrugëve, por nuk janë cekur me emër cilat rrugë, e them këtë sepse ne kemi informata se disa rrugë janë shtruar nga disa herë me dokumente ndërsa në fakt rrugët e tilla janë shtruar vetëm një herë. Për të qenë më transparent është mirë të ceket edhe emri i rrugës në raport e jo vetëm asfaltimi i disa rrugëve. Është shqetësuese pse ky buxhet kaq i madhe nuk ka arritur të realizohet në vitin që shkojë.

z.Rafet Llapashtica, theksoj, ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së e rekomandojmë këtë propozim vendim për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit. të hyrat vetanake janë buxhet i Komunës i cili mbetet në

pronësi të Komunës dhe vazhdimisht mundet me u përcjell prej vitit në vit. Është logjike, por është edhe gjë e mirë që edhe planifikimet të jenë më konkrete për arsyeje se edhe Drejtori parafolës e tha se këto mjete mund të barten vetëm për projektet e vitit 2018 që nuk kanë përfunduar, mirëpo këto mjete mund të barten ose mund të mbesin edhe për dhjetë vite ashtu siç janë të pashpenzuara. Nuk do të thotë të futen vetëm ato projekte që s'janë realizuar, unë e di që duhet të bëhet ky realizim, mirëpo tek specifikimi i projekteve është e vërtetë që i kemi disa vërejtje dhe disa kërkesa për sqarime në mënyrë që nëse këto mjete barten nga viti 2018 në vitin 2019, të specifikohen në cilat rrugë do të ndodh një gjë e tillë, e jo të futen të njëjtat rrugë çdo vit. Sido që të jetë, si pikë, ne i rekomandojmë Kuvendi të Komunës për shqyrtim dhe besoj që Drejtorët e Drejtorive përkatëse do t'i kenë përgjigjet e veta për pyetjet tona e që po ashtu besoj se deri nesër në seancë do të jenë të përgatitur.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, sqarim parafolësit z.Rafet Llapashtica, këto mjete të propozuara për bartje nga 2018 në vitin 2019, ligjërisht të gjitha mjetet që kanë mbet të pa shpenzuara, mbesin në buxhet të Kosovës derisa Kuvend i Komunës nuk i jap destinimin e caktuar. Në fakt ne me këtë po tregojmë se ku do t'i shpenzojmë, shembull, në fshatin Majac është një projekt që ka qenë bashkëfinancim me Ministrin e Infrastrukturës, tani kemi kontratë të veçantë për rrugën që lidhë fshatin Majac me Godishnjak e njohur si rruga e Bugurdollit, e cila po ashtu është në bashkëfinancim por që jemi të informuar se për pjesën që ka mbet borxh Ministria do ta paguaj, për pjesën që e kemi ne në bazë të Marrëveshjes për bashkëfinancim është dashtë ta mbulojmë ne, pra është kontrata, punët kanë filluar por nuk kanë përfunduar ende mirëpo është dashtë të bëhen pagesat fillestare dhe tani ka mbete obligim për vitin 2019, e që në realitet obligimi ligjor është i vitit 2018. Pra nuk mund të asfaltojmë rrugë sipas dëshirës, por vetëm rrugë përkatësisht projekte për të cilat kemi lidhë kontratë.

z.Rafet Llapashtica, pyetje për Drejtorin e DBF, a mund të na tregoni se sa ka borxhe Komuna.

z.Isuf Latifi, Drejtor DBF, përgjigje parafolësit, pikërisht për këtë ne jemi duke diskutuar dhe atë konkretisht madje, ne i kemi listat për secilën, këto janë borxhe në bazë të kontratës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, mendoj që Komiteti për Politik e Financa dhe Kuvendi i Komunës, duhet të informohen për borxhet e Komunës. Do të ishte mirë që çdo projekt që ka pas kontratë në vitin 2018 është dashtë të përfundoj po në atë vit ngase projekti bëhet me parashikim buxhetor dhe ju e dini këtë shumë mirë që nuk mund të filloj projekti pa u siguruar mjetet, të hapet tenderim, një herë duhet mu parashikua mjetet, mu nda mjetet, me përfundua faza e procedimit, prokurimit dhe me filluar puna. Nuk niset puna pa u nda mjetet, nuk e di qysh jetë borxh në një projekt kur janë mjetet e parapara, e jo të barten mjetet e të hyrave vetanake në rrugë të Majaci, këtë nuk mund ta kuptoj, ndoshta ju e keni mirë, vetëm për mua një Drejtori profesionale, cila do qoftë ajo, një projekt kur e nis dhe e fut në fazë të prokurimit, së pari parashihen mjetet për atë projekt, e jo projekti kryhet puna niset projekti tani vjen te ne në Kuvend të Komunës për miratim.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSH, theksoi, është e drejtë që secili këshilltar të kërkoj sqarime se ku dhe për cilin projekt do të barten këto të hyra, unë si Drejtor i SHPMSH e them se projektet e propozuara për bartje të të hyrave në kuadër të kësaj Drejtorie, janë projekte dy vjeçare, për çka edhe mund t'ju jap një listë për ato rrugë ku do të përfundohen këtë vit. Po ashtu te riparimi i urave janë kontrata dy vjeçare dhe janë kontrata të cilat nuk kanë përfundua vitin e kaluar, faktikisht është borxh që vazhdon dhe ne do t'i mbulojmë ato sepse duhet të përfundojnë punët gjatë këtij viti, mirëpo më konkretisht mund t'ju informojmë në seancën e Kuvendit për secilin projekt veç e veç se ku do të barten mjetet.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Propozim Plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSBB për vitin 2019

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSSH, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, **në cilësinë e koordinatorit të KKSBB-së** e paraqiti fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi, të gjitha pikat e parapara janë të paraqitura në material, pika të cilat kemi menduar se do të jenë të diskutueshme edhe gjatë këtij viti, por me gjithë dëshirë presim edhe ndonjë pikë që ne nuk e kemi paraparë dhe e që begaton këtë plan, qoftë sot në këtë mbledhje qoftë në atë të Kuvendit të Komunës.

Temat e parapara, konsiderojmë se janë kryesisht probleme komunale të lëmive të ndryshme, e që brenda një pike mund të diskutohen më shumë tema tjera, por në asnjë prej tyre nuk kemi krijuar lista të projekteve sepse në secilin takim, Kryetari i komunës apo anëtarët e KKSBB-së kanë të drejtë të propozojnë dhe fusin pika të ndryshme edhe përkundër asaj që nuk janë të parapara në Plan. Materialin e keni marrë me kohë dhe sigurisht e keni analizuar, andaj mund të paraqitni propozime qoftë këtu sot qoftë në seancën e Kuvendit.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, falënderoj Drejtorin respektivisht KKSBB-së për angazhimet tyre. Theksoi, vërtetë grupi punues për këtë pikë ka pas një kohë të shkurtër për të përgatitur ngase kështu është paraparë me plan të punës së kuvendit që ky plan i KKSBB-së të shqyrtohet në këtë seancë, andaj nëse nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, kush jeni që t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Propozim vendimi për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër Kompanisë Kosovare për Distributim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi, në periudhën 21.12.2018 deri me 14.02.2019 në DPKGJ dhe në DPUMM janë paraqitur 5 kërkesa për ndërtimin e 24 trafave në shtyllë dhe 3 trafave blind, trafo të cilat do të shpërndahen në 15 zona kadastrale. Ne në takimin që kemi pasur me përfaqësuesit e KEDS-it, jemi njoftuar që për investimet dhe rrjetin e zgjerimit energjetik në Komunën tonë janë paraparë nga ana e tyre ku shuma arrin rreth 6 milion e gjysmë. Kemi një numër mjaft të madh me projekte me kërkesa nga ana e KEDS, e cila ka shfrytëzuar kohën tani para fillimit të punimeve. Është propozim i Kryetarit të Komunës, për hir të rregullimit të infrastrukturës elektroenergjetike dhe në interes për qytetarët në mënyrë që të kenë energji më të mirë dhe më kualitative, andaj kërkohet të mbështetet dhe i njëjti ti rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, mirëpo kam edhe një propozim, përkatësisht për shkak të volumit të madh të kërkesave dhe dokumentacionit përkatës, na është përvjedhur një gabim teknik në materialin e propozim vendimit, edhe pse e kemi paraparë një parcelë për dhënie në shfrytëzim në fshatin Sallabaj, një flet poseduese dhe një kopje e planit nuk ka shkua nga zyra e kadastrit, andaj nëse pranoni që mos ta ndajmë prej këtyre kërkesave dhe ta dërgojmë në Kuvend si material të kompletuar, fjala është certifikatën pronësore numër 180885 me kopje të planit që duhet ti bashkëngjitet materialit ekzistues, të cilën e kam të shumëzuar dhe jua shpërndaj këtu.

z.Fitim Haziri, theksoj, qëndrimi ynë dihet rreth KEDS-it, kemi një qëndrim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm por jo duke thënë që ne jemi kundër interesave të qytetarëve sepse KEDS-i nuk investojnë se na jemi burra të mirë, ata e kanë obligim jo vetëm këtu por në gjithë Kosovën të shtrijnë rrjetin dhe të përmirësojnë atë sepse për këtë e kanë privatizuar KEDS-in. Është e pa pranueshme sjellja e tyre dhe vendimi që është bërë nga Komuna e Podujevës që i lejon ata ti vendosin njehsorët në maje të shtyllave elektrike, kjo është e papranueshme dhe e kundërligjshme. Nuk e di me çfarë të drejte ata dalin i vjelini dhe e caktojnë shumën e energjisë elektrike pa pas qytetari qasje në to. Ne duhet të marrim një vendim që

kompaninë KEDS ta detyrojmë që ata njehsorë që i ka vendos lart në shtylla ti zhvendos poshtë që të kenë qasje qytetarët sepse është shkelje e të drejtave bazike të njeriut. Para një kohe kemi diskutuar edhe me Drejtorin e DPUMM z.Hamdi Jaha i cili ka qenë i pranishëm këtu dhe ka thënë se ne kemi me thirr përfaqësuesin e KEDS-it dhe kemi për ta diskutuar që mos të lejojmë vendosjen e njehsorëve lartë në shtylla, mirëpo një gjë e tillë është duke vazhduar, madje me nënshkrim të tij. Ne sërish jemi kundër këtyre pronave që t'i japim në shfrytëzim kompanisë private KEDS pa ndonjë kompensim (pagesë) ata e kanë detyrë dhe nuk kanë qare pa e bërë këtë shtrirje të rrjetit, pra jemi që t;ju japim prona në shfrytëzim por vetëm me kompensim.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, kemi diskutuar disa herë për KEDS-in dhe kemi jap qëndrime se KEDS duhet të disiplinohet, nuk po e di tani saktësisht edhe komunikimin dhe kompetencat e qeverisjes lokale mbi KEDS-in, unë edhe në seancën para dy muajve kam kërkuar që orët lart të mos të vendosen, por neve na ka munguar edhe organizimi i komiteteve të fshatrave dhe lagjeve të qytetit në mënyrë që qytetarët të organizohen dhe të ngritin bllokada aty, qysh në start. Mendoj që një shkresë zyrtare ka qenë e ligjshme që Drejtoria përkatëse ta dërgoj në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë. Edhe unë jam që qytetari të ketë qasje në shpenzime të veta. Sa i përket propozim vendimit, jam për vendosjen e shtyllave dhe trafostacioneve sepse nuk është kushedi far prone, krejt 2 metra katror është dhe ajo shtyllë e betonit dhe nuk mendoj që dëmtohet Komuna, por edhe nëse vendosen njehsorët poshtë në shtylla, duhet të kemi një kontroll e jo të sjellën faturat me çmime fikse sikurse IP TV etj të ngjashme që janë paketa fiks, mirëpo energjia elektrike nuk është fikse. Në këtë drejtim do të lusë Drejtorinë përkatëse ta dërgoj një shkresë zyrtare në organet gjegjëse qendrore. Edhe pse unë e pash që në fshatin Shajkoc KEDS kishin vendos njehsorë në shtylla lartë, madje edhe lejen e kishin pas me nënshkrim të Drejtorit z.Hamdi Jaha.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim duke përfshirë edhe propozimin shtesë të Drejtorit të DPKGJ, përkatësisht në nenin 1 të propozim vendimit shtohet edhe një paragraf, dhe atë:

1.15. Paluajtshmëria e evidentuar në Certifikatën nr.08-942-03/18085 të datës 28.02.2019 për njësinë kadastrale parcelë, P-71712038-00523-0, pronë shoqërore rrugë publike me sipërfaqe prej 1554m2 me kulturë rrugë e pa kategorizuar, pjesë nga e cila jepet në shfrytëzim sipërfaqe prej 9m2, Zona kadastrale Sallabajë.

6. Informatë e Drejtorisë së Kulturës Rinis dhe Sportit rreth; -Aktiviteteve të DKRS-së gjatë vitit 2018 dhe mbështetjet-përkrahjet buxhetore për shoqata të ndryshme joqeveritare dhe klubet sportive, -Bibliotekës së Qytetit, si dhe -Klubit të Futbollit Llapi – Podujevë.

znj.Donika Sfishta, Drejtoresh e DKRS, e paraqiti fjalën hyrëse gjegjësisht informatën në fjalë, ndër të tjera shtoi, kamë paraqitur informatën rreth aktiviteteve të DKRS-së gjatë vitit 2018, gjithashtu është paraqitur edhe mënyra e financimit që është bërë në bazë të thirrjeve publike sipas Rregullores në fuqi në nivel të përgjithshëm për financimin e OJQ-ve. Gjatë vitit 2018 janë përkrahë të gjitha OJQ-të dhe të gjitha Klubet sportive që kanë aplikuar në DKRS. Vlen të ceket se për klubet sportive i kemi bërë dy thirrje publike për shkak se ato e kanë edhe sezonin pranveror dhe sezonin vjeshtor ndërsa për kulturë dhe rini kemi bërë një thirrje ku janë subvencionuar 11 aplikues. Sa i përket informatës për bibliotekën e qytetit, besoj që të gjithë jemi në dijeni për gjendjen e bibliotekës dhe funksionim e saj e cila tani për tani nuk është duke funksionuar ku ka qenë mirëpo besoj se shumë shpejtë do të bëhet një zgjidhje, kjo për shkak të hapësirës sepse janë rreth 40000 ekzemplarë dhe duhet një hapësirë shumë e madhe andaj nuk kemi mund t'i zhvendosim për shkak to volumit të madh të librave, por nëse nxënësit/studentët vinë edhe kërkojnë libra, përmes stafit furnizohen. Sa i përket Klubit të Futbollit Llapi, nuk është që është

kompetencë e jona direkte për shkak se ajo është shndërrua në shoqëri aksionare, mirëpo meqë e keni kërkuar informatë atë e keni dhe besoj që nuk është e nevojshme të lexohet tani këtu.

z.Fitim Haziri, theksoj, do të kërkoja nga Drejtorit që të vijmë me raporte e jo me informata. Besoj që DKRS ka pasë kohë të mjaftueshëm të përgatis raport se çfarë ka bërë gjatë një viti, për planet që i ka pas, për ato që i ka realizuar dhe ato që nuk i ka realizuar, të bëhet një raport i detajuar. Për këtë informatë unë kam vërejtjet e mia, e them këtë ngase në informatë ceken aktivitetet e mbajtura dhe të realizuar nga DKRS, ceket edhe numri i spektatorëve sa ka qenë, projektet që i kanë ndihmuar klubeve të ndryshme sportive, por që është dashtë të ceken me shuma se sa janë ndihmua, nuk e di a ju keni ik apo çfarë.

znj.Donika Sfishta, Drejtoresh e DKRS, përgjigje parafolësit, sa i përket shumave të ndara janë të specifikuar në thirrjet publike për subvencionim ku ceken shumat e parapara, si dhe në informatë janë të prezantuar përfituesit.

z.Fitim Haziri, theksoi, do të thotë që për numrin e spektatorëve paska nevojë të tregohet sa kanë qenë, ndërsa për shpenzimet e projektit nuk paska nevojë të tregohen.

znj.Donika Sfishta, Drejtoresh e DKRS, sërish përgjigje parafolësit, përfituesit dhe shpenzimet e DKRS-së ekzistojnë dhe nëse dëshironi t'i shihni lirshëm mund të vini në zyrë dhe jua tregoj sepse nuk ka çfarë të fshihet.

z.Fitim Haziri, replikë me parafolësen, ti duhet me naj paraqit, njeri kur nuk din nuk është keq, por është keq kur e din që nuk din.

z.Rafer Llapashtica, theksoi, nuk dëshiroj të hyj në detaje qysh do të punoja unë po të isha në vend të Drejtoreshës së DKRS-së, por nëse kërkohet raport deri të hënën kur është seanca e Kuvendit, ai mund të përgatitet dhe të paraqitet, mirëpo si do që të jetë, ne si pikë e rekomandojmë për diskutim në Kuvendin e Komunës. Është mirë që Drejtorët e Drejtorive, përveç materialit të jenë të përgatitur edhe për ndonjë pyetje, por nuk do të thotë që vetëm brenda një seance të përgjigjen, të paktën të mos injorohet kërkesa e Kuvendit sepse nuk është në pyetje subjekti politik por institucioni i Kuvendit i cili realisht duhet të njoftohet për punën që është duke u bërë. Unë e di që mrekulli nuk mund të bëj askush sepse jemi në dijeni edhe për buxhetin që ka Komuna dhe Drejtoritë e saj, por të paktën të jeni real. Përndryshe, unë e kam lexuar materialin e DKRS-së dhe besoj që edhe për Klubin e Futbollit Llapit ka pasur përgjegjësi Komuna derisa i njëjti ka kalua në shoqëri aksionare. Edhe për formën e kalimit në shoqëri aksionare e dimë, edhe për falsifikimin e dokumentit të nënshkrimit e dimë, edhe për interferimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, edhe kemi kërkuar disa herë informata dhe raporte rreth Klubit Llapit, kryesisht ka qenë kërkesa e një këshilltari të Kuvendit nga radhët e PDK-së. Unë e di dhe e kam parasysh që Drejtoresha në fjalë është vetëm në këtë mandat dhe nuk e preferoj që e gjithë barra e punës së tjetër kujt të bie mbi të për faktin që kjo tani është në pushtet, por mendoj që secili duhet ta jep përgjegjësin vetëm për kohen kur ka qenë ose që është në pushtet.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:05'

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0018403/19

Podujevë,

28 shkurt 2019

Kryesuesi i Komitetit

Fatmir Gashi